

VENDIM
Nr. 734, datë 20.10.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 283, DATË 1.4.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E TIPAVE, RREGULLAVE, KRITEREVE
DHE PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE PËR PRODHIMIN,
RUAJTJEN DHE PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE
BLEGTORALE, NË TOKË BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5/2 e 5/4, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3, e kreut III, të vendimit nr. 283, datë 1.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Në kushtet e mungesës së planit të përgjithshëm vendor:

a) rregullat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim janë kushtet minimale për pajisjen me leje;

b) leja e ndërtimit lëshohet pas kontrollit të përputhshmërisë së projektpropozimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), e cila, në bashkërendim me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, verifikon konformitetin me dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi;

c) AZHT-ja njofton bashkinë përkatëse dhe aplikantin për kontrollin e përputhshmërisë dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave;

ç) bashkia kryen verifikimin në terren, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për planifikimin e territorit, përfshirë edhe rregullat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe njofton AZHT-në;

d) në rast se, si pasojë e verifikimeve në terren, rezulton që propozimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas këtij vendimi dhe dokumentet e planifikimit të territorit në fuqi, kryetari i bashkisë merr vendim për miratimin e lejes së ndërtimit dhe i propozon Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të vijoje procedurat për kalimin në sipërfaqe ndërtimore të tokës bujqësore, objekt i lejes së ndërtimit. Kjo ministri, më pas, harton projektvendimin, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave;

dh) pas miratimit të kalimit të tokës bujqësore në sipërfaqe ndërtimore, bashkia i dorëzon kërkesit dokumentin e lejes dhe e boton atë në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama